

Njëri nga të dyshuarit për vrasjen e policit Enver Zymberi që ka ndodhur në vitin 2011, Radomir Kasallovic, pas dorëzimit të tij të martën dhe intervistimit nga EULEX-i, është liruar.

Lajmin e ka bërë të ditur mbrëmë për media avokati i tij, Lubomir Pantovic.

Sipas tij, Kasallovic është intervistuar të martën nga hetuesit e EULEX-it në jug të Mitrovicës dhe pastaj është liruar dhe do të mbrohet në liri.

Ndryshe, në lidhje me vrasjen e Enver Zymberit dyshohen gjithsej gjashtë serbë të veriut për të cilët ekziston fletarrest ndërkombëtar.